



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2025

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të Insitutit të Statistikave, për periudhën Janar - Dhjetor 2024.

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

Instituti i Statistikave, mbështetur në ligjin me nr. 17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare”, është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2022-2026, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioritetëve të institucionit. Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2024, i miratuar me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, është **985,910,000 (nëntëqind e tetëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e dhjetë mijë)** lekë. Këto fonde, Insituti i Statistikave i administron në një program buxhetor “Veprimtaria Statistikore”, si më poshtë vijon:

- Fondi i Pagave: 569,162,000 lekë
- Fondi i Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore: 95,102,000 lekë
- Mallra dhe shërbime të tjera: 111,037,000 lekë
- Transferta korente të brendshme: 1,574,000 lekë
- Transferta për buxhete familjare dhe individë: 6,035,000 lekë

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

- Fondi për investime të brendshme të patrupëzuara: 3,515,500 lekë
- Fondi për investime të brendshme të trupëzuara: 89,484,500 lekë
- Fondi për investime të huaja: 110,000,000 lekë

Numri i punonjësve për vitin 2024 në strukturë, i miratuar me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar është, plani: 236 dhe fakti: 226.

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria statistikore”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit, të hartuar gjatë procesit të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit. Monitorimi i buxhetit të INSTAT, për periudhën Janar-Dhjetor 2024, përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Për Insitutin e Statistikeve, gjatë 12-mujorit 2024, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë kësaj periudhe, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

në lekë

Programet	Buxheti fillestar 2024	Buxheti me ndryshime 2024	Diferenca
	(1)	(2)	(3=2-1)
Veprimtaria statistikore	1,182,500,000	985,910,000	-196,590,000

Ndryshimi i planit të vitit 2024 gjatë 12- mujorit, paraqitet me diferenca për shkak të akordimit të fondeve për përdorimin e fondit të veçantë dhe akteve normative të Ministrisë së Financave.

Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
- Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
- Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vilazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

- Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vrojttimeve, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.
- Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vrojtimet statistikore.
- Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit, nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilimit të zyrave.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të ligjit me nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, për periudhën e raportuar, Insituti i Statistikave ka realizuar vlerën buxhetore në shumën prej **971,738,867 lekë ose 98.5 % të fondit të planifikuar për vitin 2024.**

➤ Performanca e shpenzimeve në fund të vitit 2024

Në fund të vitit 2024, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin e periudhës paraqitet si më poshtë:

në lekë

Llog. Ekonomike	Përshkrimi	Plan buxheti vjetor 2024	Plan buxheti vjetor i ndryshuar 2024	Buxheti i realizuar viti 2024	Realizimi në % viti 2024
600	Paga	476,751,000	569,162,000	561,965,338	98.7
601	Kontribute Sig. Shoq. dhe Shëndetësore	83,149,000	95,102,000	92,918,767	97.7
602	Mallra dhe shërbime të tjera	371,026,000	111,037,000	97,873,830	88.1
604	Transferime korente	1,574,000	1,574,000	751,400	47.7
606	Transferime buxhetesh familjare	0	6,035,000	5,695,882	94.4
230	Kapitale të patrupëzuara	0	3,515,500	3,067,000	87.2
231	Kapitale të trupëzuara	150,000,000	89,484,500	12,138,439	13.5
231	Financim i huaj	100,000,000	110,000,000	188,316,420	171.2
	Të ardhura jashtë limitit	0	0	9,011,791	0.0
	TOTALI	1,182,500,000	985,910,000	971,738,867	98.5

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

➤ **“Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”** (artikulli 600-601)

Struktura e Insitutit të Statistikave është miratuar me Vendim të Kuvendit me nr. 16/2024, datë 15.02.2024 *“Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të INSTAT”* i ndryshuar, me në total 236 punonjës. Për vitin 2024, fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është realizuar në zbatim të numrit të punonjësve, i miratuar në strukturë me ligjin nr. 97/2023 *“Për buxhetin e vitit 2024”*, i ndryshuar, në total 236 punonjës dhe punonjësit me kontratë të përkohshme pune në total 1676 punonjës.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar për vitin 2024, për zërin **“Paga” (artikulli 600)** është 571,819,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar **561,965,338 lekë**, ose **98.7%** e planit vjetor 2024.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar për vitin 2024, për zërin **“Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore”(artikulli 601)**, është 95,102,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar **92,918,767 lekë**, ose **97.7 %** e planit vjetor 2024.

Në zërin *“Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore”* përfshihen pagat e punonjësve të strukturës të Insitutit të Statistikave, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave, mbështetur në përllogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas shkresës me nr. 627 prot. datë 08.04.2024 të Insitutit të Statistikave *“Mbi transferimin e fondeve buxhetore”* drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 670,000 lekë nga pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të strukturës së Insitutit të Statistikave dhe iu shtuan 335,000 lekë Zyrës Rajonale Statistikore Elbasan dhe 335,000 lekë Zyrës Rajonale Statistikore Lezhë, në zbatim të Vendimit të Kuvendit me nr. 16/2024, datë 15.02.2024 *“Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të INSTAT”*, i ndryshuar.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas shkresës me nr. 1113 prot. datë 03.06.2024, të Insitutit të Statistikave *“Mbi transferimin e fondeve buxhetore”* drejtuar Ministrisë së Financave ku u pakësuan 8,000,000 lekë nga artikulli 600 dhe 601 dhe u shtuan në artikullin 602 të kapitullit 5 *“Të ardhura nga Banka e Shqipërisë”*, për pagat e anketuesve me kontratë shërbimi.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas shkresës me nr. 10086/2 prot. datë 01.08.2024, të Ministrisë së Financave *“Miratim Limiti”*, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 107,884,000 lekë nga artikulli 602 dhe u shtuan në

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

artikullin 600 dhe 601 të kapitullit 1 “Njësi statistikore të vrojtuar”, për pagat e anketuesve me kontratë pune, si rezultat i mungesës së fondeve për mbulimin deri në fund të vitit kalendarik 2024.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas shkresës me nr. 10872/1 prot. datë 28.08.2024 , të Ministrisë së Financave “Transferim fondi për vitin 2024”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 10,212,000 lekë nga artikulli 602 dhe u shtuan në artikullin 600 dhe 601 të strukturës dhe Zyrate Rajonale Statistikore, si rezultat i V.K.M.-së me nr. 421, datë 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, si dhe V.K.M.-së me nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas shkresës me nr. 10087/3 prot. datë 04.10.2024 , të Ministrisë së Financave “Transferim fondi për vitin 2024”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 34,268,000 lekë nga artikulli 602 dhe u shtuan në artikullin 600 dhe 601 “Njësi statistikore të vrojtuar”, për pagat e anketuesve me kontratë pune, si rezultat i mungesës së fondeve për mbulimin deri në fund të vitit kalendarik 2024.

Ndryshime në buxhet për zërin paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë kryer sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar, me shkresën nr. 2495 prot. datë 26.12.2024 të Insitutit të Statistikave, drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 19,000,000 lekë nga artikulli 600 dhe 601 “Njësi statistikore të vrojtuar”, dhe 21,000,000 lekë nga artikulli 600 dhe 601 “Personel i trajnuar”.

➤ **“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”.** (artikulli 602)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, i ndryshuar, për vitin 2024 për zërin “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera” është **111,037,000** lekë dhe janë shpenzuar **97,873,831** lekë ose **88.1%** e planit vjetor.

Në zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” përfshihen pagat e anketuesve me kontratë shërbimi, shpenzime ndaj të tretëve, si dhe shpenzime për blerje dhe shërbime të ndryshme për institucionin.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera janë kryer sipas shkresës me nr. 1113 prot. datë 03.06.2024 të Insitutit të Statistikave “Mbi transferimin e fondeve buxhetore” drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 8,000,000 lekë nga artikulli 600 dhe

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

601 dhe u shtuan në artikullin 602 të kapitullit 5 “Të ardhura nga Banka e Shqipërisë”, për pagat e anketuesve me kontratë shërbimi.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera janë kryer sipas aktit normativ nr. 3 datë 28.08.2024, të Ministrisë së Financave “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 Për buxhetin e vitit 2024*” të ndryshuar, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 4,350,000 lekë nga artikulli 602 kapitulli 1 dhe u shtuan në artikullin 602 kapitulli 5, “*Njësi statistikore të vrojtuar*”, për pagat e anketuesve me kontratë shërbimi, si rezultat i mungesës së fondeve për mbulimin deri në fund të vitit kalendarik 2024.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera janë kryer sipas shkresës me nr. 10087/3 prot. datë 04.10.2024 , të Ministrisë së Financave “*Transferim fondi për vitin 2024*”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 34,268,000 lekë nga artikulli 600 dhe 601 dhe u shtuan në artikullin 602 “*Njësi statistikore të vrojtuar*”, për pagat e anketuesve me kontratë shërbimi, si rezultat i mungesës së fondeve për mbulimin deri në fund të vitit kalendarik 2024.

Ndryshime në buxhet për zërin shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera janë kryer sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024, të Ministrisë së Financave “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 Për buxhetin e vitit 2024*” të ndryshuar, me shkresën nr. 2495 prot. datë 26.12.2024 të Insitutit të Statistikave, drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 105,000,000 lekë nga artikulli 602 “*Njësi statistikore të vrojtuar*” të panifikuara për zhvillimin e Censit të Bujqësisë, dhe 10,000,000 lekë nga artikulli 602 “*Personel i trajnuar*”.

Pakesimet në zërin shpenzime për mallra dhe shërbime kanë ardhur si rrjedhojë sepse procedurat e prokurimit dhe fondi i pagave për anketuesit me kontratë shërbimi që ishin planifikuar për tu zhvilluar në kuadër të Censit të Bujqësisë nuk u zhvilluan.

Për e vitin 2024 realizimi në grupin e shpenzimeve operative është mbështetur duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

1. Shërbimi i ruajtjes me roje civile sipas kontratës me nr. 2390 prot., datë 29.12.2023, nënshkruar midis Insitutit të Statistikave dhe Operatorin Ekonomik me kapital shtetëror “Illyrian Guard” sh.a, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.177, datë 04.04.2019 “*Për krijimin e Shoqërisë "Illyrian Guard" sh.a dhe për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie*”.

Për fondin e parashikuar për grup artikullin “*Shërbimi i ruajtjes me roje civile*”, për godinën e Insitutit të Statistikave, për vitin 2024, vazhdoi kontrata e shërbimit me nr. 2390 prot., datë 29.12.2023, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

2. Shërbimi i marrjes me qera të ambientit të magazinimit të tabletave të blera në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, sipas kontratës me nr. 861/3 prot., datë 26.12.2023, me nr. repertori 2404 nr. koleksioni 1327, datë 11.08.2023 “Amendim Kontratë Qeraje” nënshkruar midis Institutit të Statistikave dhe operatorin ekonomik Natural Health Sh.pk. Për fondin e parashikuar për grup artikullin " *Shërbimi i marrjes me qera të ambientit të magazinimit të tabletave*", për vitin 2024, vazhdoi kontrata e shërbimit me nr. 861/3 prot., datë 26.12.2023.
3. Botim Shtypshkrime për INSTAT ,sipas marrëveshjes kuadër me nr. 895/18 prot., datë 30.07.2024, nënshkruar midis Institutit të Statistikave dhe operatorëve ekonomikë Filara Sh.pk, Dhimitër Vasi dhe AlbDesin. Për fondin e parashikuar për grup artikullin " *Botim Shtypshkrime për INSTAT*", për Instat për vitin 2024, vazhduan minikonkurset pëe lidhjen e kontratave.
4. Për fondin e parashikuar për "*Blerje bazë materiale (elektrike, hidraulike dhe telekomunikacioni)*", në vlerën 450,000 është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik “Natasha Vaska”, me vlerë ekonomike të ofertuar 235,200 lekë me tvsh ose 52% e fondit të planifikuar.
5. Për fondin e parashikuar për "*Blerje Bileta Avioni*", në vlerën 3,000,000 lekë me tvsh, janë realizuar, sipas rastit, procedurat e blerjes nëpërmjet sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe është shpenzuar në total në vlerën 2,220,330 lekë me tvsh, ose 74% e fondit të planifikuar. Për shpenzimet e kryera për blerje bileta avioni janë zhvilluar takime pune, konferenca, trajnime etj. për punonjësit e Insitutit të Statistikave, sipas kërkesave të miratuara nga Titullari, në vijim të të cilave janë realizuar procedurat përkatëse të prokurimit, me Operatorët Ekonomikë fitues, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Objekti i Prokurimit	Fondi i parashikuar me TVSH	Vlera e kontratës me TVSH	Fituesi
Blerje Bileta Avioni	3,000,000	294,000	Odisea Travel & Tours
		49,500	Odisea Travel & Tours
		34,300	Kelvin Travel
		177,300	Kelvin Travel
		66,500	Spirit Travel & Tours
		59,300	Kelvin Travel
		173,300	Kelvin Travel
		70,500	Golden Travel & Tours
		120,500	Golden Travel & Tours
		31,500	Golden Travel & Tours
		60,000	Explorer Travel & Tours
		71,000	Golden Travel & Tours
		45,600	Kelvin Travel
		92,000	Amadeos Travel & Tours

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

		35,590	2 Feleqi
		119,000	Amadeos Travel & Tours
		98,000	Amadeos Travel & Tours
		35,500	Golden Travel & Tours
		39,800	Avia Center
		159,800	Amadeos Travel & Tours
		359,840	Amadeos Travel & Tours
		27,500	Amadeos Travel & Tours
Totali	3,000,000	2,220,330	

6. Për fondin e parashikuar për "*Blerje materiale Higjeno Sanitare*" në vlerën 799,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Solid Group", me vlerë ekonomike të ofertuar 207,600 lekë ose 26% e fondit të planifikuar.
7. Për fondin e parashikuar për "*Blerje siguracion godine dhe paisjeve të zyrës*" në vlerën 500,000 lekë me tvsh, është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Intersig Vienna Insurance Group", me vlerë ekonomike të ofertuar 408,150 lekë ose 82% e fondit të planifikuar.
8. Për fondin e parashikuar për "*Blerje siguracion për automjete*" në vlerën 250,000 lekë me tvsh është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik Intersig Vienna Insurance Group" në vlerën 176,314 lekë ose 70% e fondit të planifikuar.
9. Për fondin e parashikuar "*Hostim i Faqes së aplikacionit për sistemin WebGis* " në vlerën 400,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "AddVision Albania" me vlerë ekonomike të ofertuar 288,000 lekë me tvsh ose 72% e fondit të planifikuar.
10. Për fondin e parashikuar për "*Mirëmbajtje e kondicionerëve të dhomës së serverave*" në vlerën 600,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Altec" Shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 420,000 lekë me tvsh ose 70% e fondit të planifikuar.
11. Për fondin e parashikuar për "*Rinovim i liçencave egzistuese ESRI*", në vlerën 5,390,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit të thjeshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "GDI" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 5,280,000 lekë me tvsh ose 98% e fondit të planifikuar.
12. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim larje automjete*" në vlerën 250,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik Sorgjena Agaj me vlerë ekonomike të ofertuar 213,984 lekë me tvsh ose 86% e fondit të planifikuar.
13. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim mirëmbjtje rinovim liçencash VEEAM*", në vlerën 2,170,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit të thjeshtuar, ku ka rezultuar

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

fitues operatori ekonomik "Information Business Systems" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 1,620,000 lekë me tvsh ose 75% e fondit të planifikuar.

14. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim mirëmbjtje rinovim liçencash SAS*", në vlerën 4,866,692 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit të theshtuar, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Infosoft Systems" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 4,625,258 lekë me tvsh ose 95% e fondit të planifikuar.
15. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim mirëmbjtje rinovim liçencash FORTINET*", në vlerën 637,339 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Communication Progress" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 525,600 lekë me tvsh ose 82% e fondit të planifikuar.
16. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim profilaktik dhe riparim automjetesh*", në vlerën 790,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Kadiu" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 525,600 lekë me tvsh ose 67% e fondit të planifikuar.
17. Për fondin e parashikuar për "*Shërbim Monitorimi Mediatik*", në vlerën 893,640 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Media Intelligjencë" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 864,000 lekë me tvsh ose 97% e fondit të planifikuar.
18. Për fondin e parashikuar për "*Mirembajtje e sistemit telefonik CATT*", në vlerën 250,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Eletron Albania 2008 Ltd" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 227,820 lekë me tvsh ose 91% e fondit të planifikuar.
19. Për fondin e parashikuar për "*Mirëmbajtje e programit Alpha Claud*", në vlerën 120,000 lekë me tvsh është realizuar procedura e prokurimit nën 100,000 lekë pa tvsh, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Insituti i Mobilimeve në Biznes" shpk me vlerë ekonomike të ofertuar 117,847 lekë me tvsh ose 98.2% e fondit të planifikuar.
20. Për fondin e parashikuar për "*Hostim i faqes së aplikacionit për sistemin EëbGIS*", në vlerën 500,000 lekë me tvsh është realizuar prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Expert System" me vlerë ekonomike të ofertuar 490,800 lekë me tvsh ose 98.1% e fondit të planifikuar.
21. Për fondin e parashikuar për "*Blerje pjesë ndërrimi për kompjutera, UPS-sa dhe servera*", në vlerën 2,800,000 lekë me tvsh është realizuar prokurimit me vlerë të vogël, ku ka rezultuar fitues operatori ekonomik "Information Business System" me vlerë ekonomike të ofertuar 2,688,000 lekë me tvsh ose 96% e fondit të planifikuar.

➤ **"Transferta korrente të brëndshme".** (artikulli 604)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit, për vitin 2024, për zërin ***"Transferta korrente të brëndshme"*** është 1,574,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar **751,400 lekë**, ose **47.7 %** planit vjetor. Shpenzimet e kryera janë për katër mbledhje të zhvilluara nga Këshilli i Statistikës, konkretisht në datat 08.02.2024, 04.06.2024, 17.10.2024 dhe 20.11.2024 dhe tre mbledhje të zhvilluar nga Komisioni i Nomeklaturës, në datën 11.06.2024, 14.10.2024 dhe 13.12.2024.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

➤ **“Transferta për buxhete familjare”**. (artikulli 606)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 për zërin ***“Transferta korrente të brëndshme”*** është 6,035,000 lekë, nga të cilat janë shpenzuar **5,695,882 lekë**, ose **94.4%** planit vjetor.

Fondet e shpenzuara për zërin ***“Transferta për buxhete familjare”*** janë kryer konkretisht për një rast dalje në pension, shtatë raste shpërblim për fatkeqësi, kompesimet e telefonisë celulare dhe si zbatim i V.K.M.-së nr. 846, datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”, sipas legjislacionit në fuqi.

Fondet e akorduara për zërin Fondi i Veçantë janë kryer në bazë të shkresës me nr. 775/1 prot. datë 16.02.2024 të Ministrisë së Financave “*Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të vecantë për vitin 2024*”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u shtuan 650,000 lekë dhe shkresës me nr. 176 prot. datë 31.01.2024 të Insitutit të Statistikave “*Mbi transferimin e fondeve buxhetore*” drejtuar Ministrisë së Financave ku u shtuan 625,000 lekë me transferim fondi nga llogaria 602 te llogaria 606 për kompesim të telefonisë celulare.

Fondet e akorduara për zërin Fondi i Veçantë janë kryer në bazë të shkresës me nr. 17880/4 Prot. datë 31.12.2024 të Ministrisë së Financave “*Dërgohet akordim fond i veçantë për vitin 2024*”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u shtuan 4,760,000 në zbatim të V.K.M. nr. 846, datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”

➤ **“Shpenzime për Investime”**. (artikulli 230-231)

Bazuar në ligjin me nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, plani i buxhetit për “*Shpenzime për Investime*” nga buxheti i shtetit i ndryshuar është në shumën 89,484,500 lekë.

Realizimi i Investimeve me financim të brendshëm për vitin 2024 është realizuar në shumën 12,138,439 lekë, e ndarë sipas zërave “*Likujdim TVSh*” në shumën 8,203,504 lekë, dhe “*Investimë të brëndshme*” në shumën 3,934,935 lekë.

Likujdimi i TVSh- së është kryer sipas faturave që Insituti i Statistikavë ka bërë pagesat me llogaritë e projekteve me bankat e nivelit të dytë të donatorëve.

1. Për fondin e parashikuar për “*Blerje licensa " ADOBE Creative Cloud for teams"*”, në vlerën 360,000 lekë me tvsh me vlerë ekonomike të ofertuar nga operatori ekonomik InfoSoft System sh.p.k me vlerë 322,639 lekë me tvsh ose 89% e fondit të planifikuar.
2. Procedura “*Blerje SSD dhe Wi-Fi Adapter*” fituar Introvus Solution me vlerë 35,000 lekë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

3. Procedura “Blerje licenca SPPS” me vlerë 3,241,296 lekë me tvsh fituar nga "Infosoft System " Sh.P.K dhe Blerje licenca EOP” me vlerë 336,000 lekë me tvsh fituar nga "Infosoft System " Sh.P.K .

Është lidhur kontrata për procedurën Lot 1 “Blerje Servera dhe Storage” me operatorin ekonomik “Comunication Progress” Sh.P.K me vlerë 29,352,000 me tvsh nr, 1430/30 prot. datë 20.12.2024 dhe obliguar me urdhër blerje nr. 88049, kontratë e cila pritet të realizohet në fillim të vitit 2025. Procedura Lot 2 “Blerje Kompjutera, Workstation, Laptop” me fond limit 45,670,531 me tvsh nuk është realizuar për vitin 2024 është në proces ankimi në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Ndryshime në buxhet për zërin “Investime të Brendshme” janë kryer sipas shkresës me nr. 9284/1 prot. datë 08.08.2024 të Ministrisë së Financave “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, drejtuar Insitutit të Statistikave, ku u pakësuan 3,515,500 lekë nga artikulli 231 dhe u shtuan në artikullin 230, “Rikonstruksion Godine (Hartim Projekti)”. Me shkresën me nr. 510/2 Prot., datë 24.03.2023 “Kthim përgjigje suajës me nr. 433 prot.”, Instituti i Ndërtimit, midis të tjerave, ka cilësuar se niveli i dëmtimit të objektit “Godinë nr. 35 të INSTAT-it, Rruga “Vllazën Huta”, Tiranë përkon me shkallën e dëmtimit DS4 (Rikonstruksion).

Është bërë akt ekspertizë e thelluar për godinën e Insitutit të Statistikave nga Universiteti Politeknik i Tiranës me vlerë 2,976,000 lekë dhe opionencë teknike e akt ekspertizës së thelluar Insitutit i Ndërtimit për godinën e Insitutit të Statistikave me vlerë 100,000 lekë.

Ndryshime në buxhet për zërin “Investime të Brendshme” janë kryer sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar, me shkresën nr. 2495 prot. datë 26.12.2024 të Insitutit të Statistikave, drejtuar Ministrisë së Financave, ku u pakësuan 57,000,000 lekë nga artikulli 231, “Shpenzime kapitale”. Pakesimet në zërin Investime të Brënshe kanë ardhur si rrjedhojë sepse procedurat e prokurimit që ishin planifikuar për tu zhvilluar në kuadër të Censit të Bujqësisë nuk u zhvilluan.

Realizimi i shpenzimeve me “Financim të Huaj” për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është 188.316.420 lekë. Projektet që menaxhohen nga Instituti i Statistikave janë si më poshtë vijon:

1. Salstat - Statistika të Forta Vendore.
2. Mbështetje për CENS.
3. IPA 2019 Multi-Beneficiary Statistical Cooperation Programme.
4. Sida Direct Funding - Instat Census 2022.

➤ **Shpenzime nga të “Ardhurat jashtë limitit”**

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë në vlerën 9,011,791 lekë.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

Realizimi në sasi sipas **treguesit të performancës/produktit** për periudhën Janar-Dhjetor 2024 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Plani	Fakti 12-mujor 2024	% Realizimit
1	Njësi statistikore të vrojtuar	281,040	243,756	86.7
2	Të dhëna të publikuara	181	175	96.7
3	Personel i trajnuar	236	226	93.2
4	Auditime të kryera	7	6	85.7
5	Blerje Liçensa	30	9	30.0
6	Blerje paisje kompjuterike	208	0	0.0

Treguesi i performancës/produktit “Njësi statistikore të vrojtuar” është realizuar 86.7%.

Treguesi i performancës/produktit “Të dhëna të publikuara” është realizuar 96.7%.

Treguesi i performancës/produktit “Personel i trajnuar” është realizuar 93.2.0 %.

Treguesi i performancës/produktit “Auditime të kryera” është realizuar 85.7%.

Treguesi i performancës/produktit “Blerje Liçensa” është realizuar 30.0%.

Treguesi i performancës/produktit “Blerje paisje kompjuterike” nuk është realizuar.

Fondet e alokuara nga artikulli 602 “Njësi Statistikore të vrojtuar” ishin të planifikuara për regjistrimin e Censit të bujqësisë i cili nuk u zhvillua. Një pjese e ketyre fondeve u alokuan për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për anketues, teknike të specialiteteve të ndryshëm, kontrollorë etj. me kontratë pune dhe pjesa tjetër është pakësuar sipas aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar .

Menaxhimi efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për Insitutin e Statistikave, në funksion të një vendimmarrje transparente do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm në realizimin e punës, në drejtim të shpenzimeve të miratuara vjetore për përmbushjen e qëllimit dhe objektivave institucionale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Alban Çela

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al